



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

-Kuvendi Komunal
01 Nr. 313-1416/1
Dt. 07.07.2011
D r a g a s h

Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e jashtëzakonshme të dt. 07.07.2011, pas shqyrtimit paraprak të kërkesës së firmës-konzorciumit “Eurokos JH & Loreto Consult AG” Zug-Zvicër, për dhënien e Pëlqimit për investime në hidrocentrale të vogla në lumenjtë e Brodit dhe Restelicës-Komuna e Dragashit, miraton këtë:

V E N D I M

- I. **JEPET PËLQIMI** për realizimin e investimeve të hidrocentraleve në lumin Brod dhe Restelicë, sipas Kërkesës dhe Projektit ideor për këtë çështje të konzorciumit “Eurokos JH & Loreto Consult AG”,
- II. Jepet Pëlqimi për shfrytëzimin e pronës publike, ku është paraparë sipas studimeve të konzorciumit ndërtimi i hidrocentraleve, bëhen kompensimet e pronës ku parashihet eksproprimi, ndërsa të gjitha taksat dhe detyrimet ndaj Kuvendit Komunal të Dragashit rrjedhin pas marrjes së licencës për operim nga Zyra Rregullative e Energjisë.
- III. Pas marrjes së Licencës nga ZRE autorizohet drejtori për Ekonomi dhe Financa i Kuvendit Komunal të Dragashit që të rregulloj çështjen e taksave për pronën shoqërore konform dispozitave ligjore në fuqi.
- IV. Pas këtij Vendimi, obligohet Konzorciumi që të vazhdon procedurat e mëtejme ligjore të cilat, pas dorëzimit të projekteve kryesore, do të ishin bazë për dhënien e Lejes së Ndërtimit nga Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër i KK-së Dragash, përfshirë këtu edhe marrjen e pëlqimeve tjera të kërkuara nga konzorciumi që obligohet ti jep Kuvendi Komunal i Dragashit për realizimin e investimit.
- V. Për rrjedhat e mëtejshme rreth realizimit të projekteve të parapara, sipas kërkesës, të njoftohet Kuvendi Komunal i Dragashit.
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit.

Arsyetim

Duke pasur parasysh rendësin ekonomike-zhvillimore, shfrytëzimin e resurseve natyrore të lumenjve dhe ruajtjen e ambientit të Komunës, si dhe nevojën për shfrytëzimin e energjisë nga rrjedhja e lumenjve të Komunës së Dragashit, në seancën e jashtëzakonshme të dt. 07.07.2011, miratohet Vendimi për dhënien e Pëlqimit si në dispozitiv të pikës I të këtij Vendimi.

I dërgohet:

- Drejtoriatit për Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër të KK-së, drejtorit Bean Haxhihasan,
- Firmës –Konzorciumit “Eurokos JH & Loreto Consult Ag” Zug-Zvicërr, drejtorit Yll Shamolli – Prishtinë, dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH

Kryesuesi

Lulzim Rifaj

